

së Vetonit u urdhëruan që të vazhdonin rrugën. I thanë Zenelit se Azerin do ta lironin ditën tjetër, pasi që ta merrnin në pyetje. Azerin e çuan në burgun e UÇK-së në Drenoc/Drenovac. Atje e morën në pyetje dhe e rrahën. Familjarët shkuan disa herë në shtab për të kërkuar lirimin e Azerit, por pa sukses. Azerin e shihnin për herë të fundit të gjallë më 21.07.1998, në burgun e Malishevës/Mališevo. Një kohë të gjatë, familjarët nuk dinin asgjë për fatin e Azerit.

Në fillim të muajit maj të vitit 2005, familjarët u njoftuan se mbetjet mortore të Azerit ishin zhvarrosur në varrezat në *Dragodan* në Prishtinë/Priština, në muajin maj të vitit 2000. Vëllëzërit e Azerit, Zeneli dhe Ukshini, i kanë varrosur mbetjet mortore të të vëllait në varrezat e Piranës/Pirane.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka nxjerrë në muajin prill të vitit 2009 aktgjykimin e fuqiplotë me të cilën pjesëtarët e policisë ushtarake Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj dhe Agron Krasniqi u dënuan me burgim shumëvjeçar, për shkak të ndalimit të paligjshëm dhe trajtimit çnjerëzor të Azer Tarjanit dhe të burgosurve të tjerë në burgun e UÇK-së në Drenoc/Drenovac.

Burimet: deklarata Z.T, FDH-33486; OMPE, *Mbetjet.*, FDH-15297; SMIP, *Terroristički.*, III, 223; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z. 371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, FDH-29712.

Đuro (Rade) Latas

(9.07.1949, serb nga Leshaku/Lešak, komuna e Leposaviqit/Leposavić, transportues, një fëmijë)

Svetomir (Vasilije) Biševac

(21.02.1954, serb nga Ostraga/Ostraće, komuna e Leposaviqit/Leposavić, axhustator)

Đuro me familje u zhvendosën nga Slunji [Kroaci] pas aksionit të ushtrisë e policisë *Stuhija/Oluja*. Jetonin në Leshak/Lešak [komuna e Leposaviqit/Leposavić], në qendrën për strehim kolektiv [Domi i të Vetmuarve *Milan Gajić*]. Svetomiri dhe familja e tij jetonin në Leshak/Lešak, pasi e braktisën fshatin e vet të Ostragës/Ostraće.

Në datën **4.07.1998**, nga ora 3:00, Đuroja dhe Svetomiri u nisën për në Prizren me dy kamionë të ngarkuar me lëndë djegëse. Kurrë nuk arritën atje. Pas dy ditësh, bashkëshortet e tyre e njoftuan policinë për zhdukjen e burrave të vet. Ditën tjetër [7.07.1998], trupi i Svetomirit u gjet në vendin e quajtur *Te Rrasat/Ploče*, në rrugën **Rahovec/Orahovac** – Malishevë/Mališevo. Në trup i kishte disa vrima nga plumbat, gjurmë nga goditjet me mjete të topitura dhe shenjat e asfiksimit. Policia ka konstatuar se kamionët e tyre ishin vërejtur herën e fundit në rrugën ndërmjet Shtimes/Štimlje dhe Suharekës/Suva Reka. Dokumentet identifikuese të Svetomirit dhe Đurës u gjetën në kampin e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. Familjarët janë duke kërkuar ende ndriçimin e fatit të Đurës. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është regjistruar në lëndën me numër YUK-050082-01.

Burimet: USCG KGDH, *Regjistri.*, FDH-8817; SMIP, *Terroristički.*, III, 77; KMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; AIS, *Zona.*, 57, 61, FDH-16913; KNKK, *Persona të zhdukur.*, FDH-9795; *Body of Unidentified Man Taken to Prizren Morgue*, pasqyra e lajmeve, KIC, 09.07.1998, FDH-29357.

Hysen (Ibrahim) Krasniqi

(1.09.1951, shqiptar nga Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor, tetë fëmijë)

Hyseni punonte si rojtar në ndërmarrjen *Pira*, në fshatin Xërxë/Zrze. Në datën 4.06.1998, nga ora 14:00, tre pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së nga shtabi në Drenoc/Drenovac [emrat e tyre janë të njohur për FDH], erdhën te shtëpia e Hysenit. I thanë të nisej me ta në një aksion dhe ta merrte me vete makinën, sepse koha nuk do tu lejonte atyre që ta kthenin Hysenin në shtëpi. Një ditë më vonë, vëllëzërit e Hysenit, Halili dhe Bardhyli, të cilët ishin pjesëtarë të UÇK-së, u kthyen në shtëpi nga pozicionet e UÇK-së. Kur mësuan se Hysenin e kishin marrë, ata shkuan menjëherë në shtabin e UÇK-së në **Drenoc/Drenovac**, për tu interesuar për fatin e të vëllait. Një ushtar i UÇK-së [emri